



# Urdhri i Punonjësve Socialë

## STATUTI

### URDHRI I PUNONJËSVE SOCIALË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Statuti i Urdhrit të Punonjësve Socialë në Republikën e Shqipërisë është i bazuar në Ligjin Nr. 163/2014 “Për Urdhrit të Punonjësve Socialë në Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin nr 141/2020, në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, të Kushtetutës.

## **KREU I**

### **DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

Ky statut ka për qëllim rregullimin normativ të të gjithë veprimtarive të Urdhrit të Punonjësve Socialë, organeve të tij, si një akt i brendshëm për zbatimin e Ligjit dhe mbarëvajtjen e veprimtarisë në bazë të tij.

Statuti miratohet nga Këshilli Kombëtar i Urdhrit të Punonjësve Socialë.

### **Neni 2**

#### **Fusha e zbatimit**

1. Urdhri i Punonjësve Socialë është autoriteti i vetërregullimit profesional, i pavarur, i depolitizuar, i hapur dhe i barabartë për të gjithë anëtarët, pavarësisht përkatësisë së tyre gjinore, racore, etnike, fetare a filozofike, ekonomike, gjuhësore, bindjeve politike apo orientimit seksual.
2. Urdhri i Punonjësve Socialë ka shtrirje në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

### **Neni 3**

#### **Statusi**

1. Urdhri i Punonjësve Socialë është ent publik jobuxhetor i pavarur, i cili përfaqëson dhe mbron interesat e përbashkët të anëtarëve të Urdhrit të Punonjësve Social dhe rregullon veprimtarinë dhe marrëdhëniet midis tyre, në funksion të publikut.
2. Urdhri i Punonjësve Socialë organizohet sipas Ligjit nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për funksionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike”, sipas të cilit me Ent Publik kuptohet çdo subjekt i së drejtës publike, joshtetëror, i krijuar me ligj dhe që synon realizimin e një interesi publik.

#### **Neni 4 Misioni**

1. Misioni i Urdhrit të Punonjësve Socialë është garantimi dhe ruajtja në vazhdimësi e standardeve dhe praktikave të mira të ushtrimit të profesionit në fushën e punës sociale, garantimi i cilësisë maksimale për shërbimet e ofruara nga profesionistë punonjës social dhe mbrojtja e publikut nga veprimet jo profesionale dhe jo etike të punonjësve socialë.

#### **Neni 5 Bashkëpunimi**

1. Urdhri, gjatë kryerjes së detyrave, mban lidhje të vazhdueshme me ministritë përgjegjëse për çështjet sociale, arsimin, shëndetësinë, punët e brendshme, drejtësinë dhe institucionet e tyre të varësisë, institucionet e pavarura dhe organizma të tjerë, publikë ose privatë, të krijuar sipas legjislacionit në fuqi.

2. Urdhri i Punonjësve Socialë informon çdo 6 muaj ministritë e përmendura në pikën 1 të këtij neni, sipas fushës së tyre të përgjegjësisë, lidhur me anëtarësimet, gjykimet disiplinore dhe ecurinë e tyre në të gjitha shkallët e gjyimit profesional.

3. Inspektoratet në fushën e përgjegjësisë shtetërore të ministrive, të përmendura në pikën 1 të këtij neni, bashkëpunojnë me Urdhrin gjatë ushtrimit të funksionit të tij.

4. Ministritë e përmendura në pikën 1 të këtij neni bashkëpunojnë me Urdhrin për hartimin e projektakteve ligjore dhe nënligjore, si dhe dokumenteve të rëndësishme në fushën e shërbimeve sociale dhe punës sociale.

### **KREU II ANËTARËSIMI NË URDHRIN E PUNONJËSVE SOCIALË**

#### **Neni 6 Kriteret e anëtarësisë**

1. Janë anëtarë të Urdhrit të Punonjësve Socialë të gjithë punonjësit socialë që përmbushin kriteret e mëposhtme:

a) të jenë shtetas shqiptarë;

b) të zotërojnë diplomë të studimeve të larta “Bachelor” në fushën e punës sociale dhe diplomë të nivelit të dytë “Master Shkencor/Profesional” në të njëjtën fushë, lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë, brenda apo jashtë vendit, si dhe të njohura e të njehsuara në Republikën e Shqipërisë nga ministria përgjegjëse për arsimin.

c) të mos jenë të dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje, në momentin e kërkesës për anëtarësim;

ç) të njohin dhe të zotohen me shkrim se do të zbatojnë kërkesat e legjislacionit në fuqi, statutit, dhe Kodin e Etikës dhe Deontologjisë të Punonjësit Social.

2. Shtetasit e huaj, për ushtrimin e profesionit të punonjësit social në Republikën e Shqipërisë, detyrohen të anëtarësohen paraprakisht në Urdhrin e Punonjësve Socialë të Republikës së Shqipërisë dhe të njohin

të gjitha aktet ligjore e nënligjore që rregullojnë profesionin e punonjësit social. Punonjësi social, shtetas i huaj, që të ushtrojë profesionin si rezident në Shqipëri apo i atashuar në një institucion ku vjen periodikisht për ushtrimin e profesionit, duhet të ketë edhe këto dokumente:

- a) lejen e qëndrimit dhe të punës në Republikën e Shqipërisë;
- b) certifikatën e mirësjelljes (Good Standing Certificate) nga urdhri/dhoma apo shoqata e punonjësve socialë të vendit të vet, ku vërtetohet se është i regjistruar, e ushtron profesionin dhe se nuk ka marrë masa ndëshkimore;
- c) njohjen e diplomës dhe certifikatave të specializimeve të kryera prej tij nga autoritetet përkatëse në Shqipëri;
- ç) një rekomandim nga një specialist vendas i licensuar i së njëjtës fushë, anëtar i Urdhrit të Punonjësve Sociale.

Për punonjës social të huaj, i cili nuk njihet gjuhën shqipe, detyrimisht është kusht të punojë me përkthyes kostot e të cilit mbulohen nga vetë punonjësi social.

4. Individëve të përcaktuar në pikën 1, të këtij neni, që, në momentin e hyrjes në fuqi të legjislacionit për profesionet e rregulluara për punonjës social, kanë të dokumentuar formimin dhe kualifikimin profesional për ushtrimin e këtij profesioni, sipas shkronjës “b”, të pikës 1, të këtij neni, u lind e drejta e menjëhershme e anëtarësimit në Urdhër.

#### **Neni 7** **Detyrimi për anëtarët**

1. Asnjë individ nuk mund të ushtrojë profesionin e punonjësit social në sistemin publik apo privat në Republikën e Shqipërisë, pa qenë anëtar i Urdhrit të Punonjësve Socialë dhe pa qenë i pajisur me licencën për ushtrimin individual të profesionit të lëshuar nga ky organizëm.
2. Anëtarët e Urdhrit të Punonjësve Socialë kanë detyrim të paguajnë rregullisht kuotizacionet e anëtarësisë, tarifën e regjistrimit, të licencimit dhe për shërbime të tjera administrative.
3. Të respektojë ligjet dhe rregullat që lidhen me ushtrimin e profesionit sipas normave të Kodit Etik-Deontologjik.
4. Të përfshihet në edukimin e vazhdueshëm profesional, për të garantuar përditësimin e njohurive me të reja në fushën e praktikës profesionale.
5. Punëdhënësit e institucioneve publike dhe private ndalohen t'i punësojnë punonjës socialë në kundërshtim me këtë dispozitë.

#### **Neni 8** **Konfidencialiteti**

1. Anëtarët e Urdhrit të Punonjësve Socialë janë të detyruar të ruajnë dhe të mos shpërndajnë informacione personale apo konfidenciale të klientëve për të cilat kanë rënë në dijeni gjatë ushtrimit të profesionit përveç rasteve kur individi/prindi/kujdestari ligjor ka dhënë pëlqim me shkrim.
2. Në rast të shpërndarjes së informacioneve të karakterit sensitiv në mënyrë të paautorizuar nga ana e anëtarit të Urdhrit të Punonjës Social, do të zbatohen sanksionet e parashikuara në Ligjin Nr.9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të Dhënave Personale” si dhe parashikimet e këtij statuti për dhënien e masave disiplinore.

3.Përrjashtohen nga kufizimet e pikës 1 të këtij neni, te gjitha rastet për të cilat Punonjësi Social merr dijeni për shkak të ushtrimit të profesionit dhe që e vendosin klientin në pozitën e viktimës/autorit si rezultat i veprimeve të kundraligjshme të personave të tij/tjerë.

4.Bazuar në pikën 3 të këtij neni si dhe në mbrojtjen e interesit më të lartë të klientit, punonjësi social detyrohet të raportojë siç parashikon legjislacioni në fuqi.

### **Neni 9**

#### **Të drejtat e anëtarit**

Anëtari i Urdhrit ka të drejtë:

- Të ushtrojë profesionin e punës sociale në përputhje me legjislacionin në fuqi, me normat e etikës dhe Kodin Etiko-Deontologjik;
- Të kërkojë mbrojtje nga Urdhri për shkeljen e të drejtave të tij profesionale dhe etike;
- Të zgjedhë e të zgjidhet në organet e Urdhrit të Punonjësve Socialë;
- Të marrë pjesë në shqyrtimin nga organizmat e Urdhrit të Punonjësve Socialë për probleme që kanë të bëjnë me të;
- Të ankimojë vendime të Urdhrit të Punonjësve Socialë kur i gjykon të padrejta.

### **Neni 10**

#### **Mbrojtja e anëtarit**

Procedurat dhe modalitetet e mbrojtjes së anëtarit të Urdhrit të Punonjësve Social ndiqen sipas rregullores së brendshme të hartuar nga Urdhri i Punonjësve Social.

### **Neni 11**

#### **Pagesa për anëtarësim**

1. Kërkuesi paguan tarifën, e cila përcaktohet çdo vit me vendim të Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Punonjësve Socialë për veprimet e kryera për anëtarësim, regjistrim dhe licensim.
2. Për subjektet e huaja, Këshilli Kombëtar mund të vendosë tarifa të veçanta.

### **Neni 12**

#### **Refuzimi i anëtarësimit në Urdhër**

1. Anëtarësimi në urdhër mund t'i refuzohet të interesuarit vetëm në rastet e mëposhtme:
  - a) Kur nuk plotëson kriteret e kërkuara nga ligji.
  - b) Kur nuk paguhen kuotat përkatëse të Urdhrit të Punonjësve Socialë.
  - c) Kur është marrë vendim i formës së prerë kundër të interesuarit, që e dënon me ndalim të ushtrimit të profesionit.
2. Vendimi i refuzimit të anëtarësimit në Urdhër të Punonjësve Socialë i duhet komunikuar kërkuesit me shkrim dhe në mënyrë të argumentuar dhe nuk përjashton rrugën administrative të ankimit.

3. Procedura e anëtarësimit dhe ndërprerjes së anëtarësisë përcaktohet në rregulloren e regjistrimit, anëtarësimit dhe liçencimit të miratuar nga Këshilli Kombëtar.

### **Neni 13**

#### **Humbja e statusit si anëtar i Urdhrit**

Antarësimi në Urdhri e Punonjësve Socialë pushon në këto raste:

- a) Kur anëtari ndërron jetë
- b) Me kërkesë të vetë anëtarit, pa shmangur detyrimet që janë për t'u përmbushur ndaj Urdhrit të Punonjësve Socialë.
- c) Kur ka një dënim për ndalim të ushtrimit të profesionit të dhënë me vendim gjyqësor të formës së prerë.
- d) Për mospagesë të kuotës së urdhrit ose të kontributetve të tjera të parashikuara nga Urdhri I Punonjësve Socialë për më shumë se një muaj nga momenti kur është vënë në dijeni zyrtarisht për faktin.
- e) Në rastin e kryerjes së një sanksioni disiplinor të dhënë, në përputhje me parashikimet në Statut.
- f) Kur është marrë vendim i formës së prerë kundër të interesuarit, që e dënon me ndalim të ushtrimit të profesionit.

2. Këshilli Kombëtar mund të vendosë për pezullimin e përkohshëm të anëtarësimit kur vihet në dijeni për hapjen e një çështje gjyqësore ose procedim të një anëtari për një vepër penale, masa e dënimit të së cilës mund të parashikojë edhe ndalimin e ushtrimit të profesionit. Ky vendim i marrë duhet të jetë i motivuar, duke dëgjuar paraprakisht të interesuarin dhe i bazuar në rrethanat përkatëse.

### **Neni 14**

#### **Ankimi për refuzimin e anëtarësimit dhe humbjes së statusit të anëtarit**

1. Ndaj vendimit që refuzon kërkesën për anëtarësim e regjistrim ose që vendos humbjen e statusit të anëtarit, kërkuesi ka të drejtë të ankohet pranë Këshillit Kombëtar, jo më vonë se 30 ditë nga dita e marrjes së njoftimit për vendimin.
2. Këshillit Kombëtar e shqyrton atë jo më vonë se një muaj nga paraqitja e ankesës dhe merr vendim, i cili është i formës së prerë.
3. Kërkuesi ka të drejtë t'i drejtohet Urdhrit të Punonjësve Socialë përsëri me kërkesë për anëtarësim vetëm 12 muaj pas përgjigjes negative nga Këshilli Kombëtar dhe vetëm nëse janë plotësuar kushtet për praninë.

### **KREU III**

#### **ORGANIZIMI DHE DREJTIMI**

### **Neni 15**

#### **Organet kryesore**

1. Organet kryesore të Urdhrit të Punonjësve Socialë janë:

- a) Asambleja e Urdhrit;

- b) Këshilli Kombëtar i Urdhrit;
- c) Kryetari i Urdhrit;
- ç) Komisioni i Gjykimit Disiplinor Profesional;
- d) Komisioni i Edukimit në Vazhdim

#### **Neni 16** **Asambleja e Urdhrit**

1. Asambleja e Urdhrit është organi më i lartë i përfaqësimit dhe vendimmarrës i Urdhrit dhe përbëhet nga tërësia e anëtarëve të Urdhrit.
2. Mbledhja e asamblesë thirret nga:
  - a) Kryetari i Këshillit Kombëtar;
  - b) Kur kërkohet nga 1/5 e të gjithë anëtarëve të asamblesë.
  - c) Asambleja duhet të mbledhet të paktën një here në 2 vjet
3. Asambleja Kombëtare zgjedh Këshillin Kombëtar dhe Kryetarin e Urdhrit, me votim të fshehtë dhe me shumicë të thjeshtë të të gjithë anëtarëve të saj;
4. Me kërkesë të 1/5 të anëtarëve të Asamblesë mund të propozohen ndryshime në statut apo të tjera;

#### **Neni 17** **Këshilli Kombëtar**

1. Këshilli Kombëtar i Urdhrit të Punonjësve Socialë është organi ekzekutiv i Urdhrit, i cili përbëhet nga 15 anëtarë, ndër të cilët 10 janë të zgjedhur nga Asambleja, përfshirë Kryetarin, dhe 5 të tjerët janë përkatësisht një përfaqësues nga ministria përgjegjëse për çështjet sociale, një përfaqësues me rotacion nga ministritë e përmendura në pikën 1, të nenit 5, të këtij statuti, dy përfaqësues nga institucionet e arsimit të lartë të shkencave të punës sociale, një përfaqësues nga shoqatat e punonjësve socialë, të caktuar nga Kryetari i Urdhrit, sipas kriterëve të përcaktuara në statut.

#### **Neni 18** **Kriteret për anëtarësim në Këshillin Kombëtar**

1. Kandidatët për anëtarë në Këshillin Kombëtar, të zgjedhur nga Asambleja, duhet të plotësojnë këto kriterë:
  - a) të jenë shtetas shqiptar me banim të përhershëm në Shqipëri;
  - b) të jenë anëtarë të Urdhrit;
  - c) të kenë përvojë jo më pak se 5 (pesë) vjet në ushtrimin e profesionit të punonjësit social;
  - ç) të mos kenë marrë masë disiplinore në 5 (pesë) vitet e fundit;
  - d) të mos jenë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale.
2. Në kuadër të një procesi vendimmarrje të drejtë dhe të pavarur, përjashtohet mundësia e anëtarësimin në Këshillin Kombëtar, e dy personave të cilët mund të kenë marrëdhënie varësie të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, lidhje gjaku, marrëdhënie kredie, debie apo marrëdhënie të kësaj natyre.
3. Mandati i anëtarit të Këshillit Kombëtar është 3 vjet dhe ka të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë.
4. Këshilli Kombëtar ka këto përgjegjësi: a) miraton strukturën e vet organizative; b) cakton kuotizacionin dhe tarifin; c) administron pasuritë e luajshme dhe të paluajshme të Urdhrit në nivel kombëtar; ç)

mbikëqyr të gjithë veprimtarinë e organeve që varen prej tij; d) harton dhe miraton statutin, rregulloret e Urdhrit, si dhe Kodin e Etikës dhe Deontologjisë dh)monitoron mbajtjen dhe përditësimin e Regjistrit të Urdhrit të Punonjësve Socialë nga struktura administrative; e) miraton rregulloren e gjykimit profesional të Urdhrit. f) ngre grupe pune ad hoc për kryerjen e kontrolleve për ushtrimin e profesionit të punës sociale; g) përgatit dhe publikon raportin vjetor dhe financiar;h) jep titullin “Anëtar Nderi i Urdhrit të Punonjësve Socialë në Republikën e Shqipërisë” për personalitete me kontribute të rëndësishme në fushën e punës sociale.

5. Anëtari i zgjedhur i Këshillit Kombëtar e përfundon mandatin e tij përpara kohe kur:

a) jep dorëheqjen;

b) dënohet me vendim gjykate të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;

c) humbet zotësinë e plotë për të vepruar;

ç) bëhet i paaftë, për arsye shëndetësore, për të kryer detyrat e tij, vërtetuar nga komisioni kompetent mjekësor;

d) mungon pa arsye të justifikuar në tre mbledhje të njëpasnjëshme të Këshillit Kombëtar:

e) kryen shkelje në ushtrimin e profesionit;

f) kryen shkelje administrativo-disiplinore në organet e zgjedhura të UPSSH;

g) kryen shkelje të rënda të etikës si dhe për kryerjen e veprimeve që diskreditojnë rëndë figurën e anëtarit dhe veprimtarinë normale të Këshillit Kombëtar

h) shpërdoron detyrën;

i) nuk zbaton parimin e shmangies së konfliktit të interesit.

6. Propozimin për largimin e antërit të Këshillit Kombëtar kanë të drejtë t'ia paraqesin Këshillit Kombëtar a) 1/4 e Asamblesë Kombëtare b) 1/3 e Këshillit Kombëtar c) Kryetari i Këshillit Kombëtar d) Komisioni i Gjykimit Disiplinor Profesional.

7. Zëvendësimi i anëtarit, të cilit i është ndërprerë mandati, bëhet nga Këshilli Kombëtar me shumicë të thjeshtë me subjektin që është renditur direkt pas listës fituese në zgjedhjet e Asamblesë;

8. Cilësia e anëtarit është e papajtueshme me funksione drejtuese në administratën shtetërore dhe në forume partiake.

## **Neni 19**

### **Kriteret për përzgjedhjen e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Këshillin Kombëtar**

1. Kryetari i Urdhrit cakton si anëtar të Këshillit Kombëtar të Urdhrit, përfaqësues nga Institucionet e Arsimit të Lartë bazuar në kriteret e mëposhtme: a) në numrin e cikleve të studimeve në fushën e punës sociale b) në numrin e studenteve të diplomuar në fushën e punës sociale c) në renditjen e cilësisë së Universiteteve të bërë nga agjensi vendase dhe të huaja d) në kontributet në promovimin e profesionet të punës sociale në tre vitet e fundit.

2. Përfaqësuesit e zgjedhur nga Institucioni i Arsimit të Lartë caktuar nga kryetari duhet të plotësojnë kriteret e përcaktuara në dispozitat e nenit 18 të këtij statuti.



**Neni 20**  
**Kriteret për përzgjedhjen e përfaqësuesve nga ministritë për Këshillin Kombëtar**

1. Ministria përgjegjëse për çështjet sociale zgjedh një përfaqësues si anëtar të Këshillit Kombëtar bazuar në kriteret e përcaktuara në pikën 1 të nenit 18 të këtij statuti.
2. Kryetari cakton një nga ministritë e përmendura në pikën 1 të nenit 5 të këtij statuti të zgjedhë një përfaqësues si anëtar të Këshillit Kombëtar bazuar në kontributin e tyre në zhvillimin dhe promovimin e profesionit të punës sociale në vend.
3. Përfaqësuesi i zgjedhur nga ministria duhet të plotësojë kriteret e përcaktuara në dispozitat e nenit 18 të këtij statuti.

**Neni 21**  
**Kriteret për përzgjedhjen e përfaqësuesve nga shoqatat për Këshillin Kombëtar**

1. Kryetari cakton një nga shoqatat e punonjësve socialë të zgjedhë një përfaqësues si anëtar të Këshillit Kombëtar bazuar në kriteret e mëposhtme: a) të jetë zyrtarisht e regjistruar në gjykatë b) të jetë e themeluar mbi 3 vite c) të ketë anëtarësi dhe të ketë një historik të pasur aktivitetesh në fushën e punës sociale në vend.
2. Përfaqësuesi i zgjedhur nga shoqata duhet të plotësojë kriteret e përcaktuara në dispozitat e nenit 18 të këtij statuti.

**Neni 22**  
**Kryetari i Urdhrit të Punonjësve Socialë**

1. Kryetari i Urdhrit të Punonjësve Socialë është kryetari i Këshillit Kombëtar dhe përfaqëson Urdhrin në marrëdhëniet me palët e treta.
2. Kryetari i Urdhrit të Punonjësve Socialë zgjidhet me votim të fshehtë nga Asambleja, midis jo më pak se dy kandidaturave alternative.
3. Mandati i Kryetarit të Urdhrit është 3 vjet, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë.
4. Kandidaturat për Kryetar të Urdhrit të Punonjësve Socialë duhet të përmbushin këto kriteret:
  - a) të jenë shtetas shqiptarë, rezidentë në Shqipëri;
  - b) të jenë anëtarë të Urdhrit dhe të jenë jo më shumë se në moshën e daljes në pension në momentin e zgjedhjes;
  - c) të kenë jo më pak se 5 (pesë) vjet përvojë në ushtrimin e profesionit të punonjësit social
  - ç) të kenë aftësi komunikuese, organizuese dhe drejtuese;
  - d) të mos jenë marrë ndaj tyre masa ndëshkimore disiplinore në 5 vitet e fundit;
  - dh) të mos jenë dënuar me vendim gjykate, të formës së prerë, për kryerjen e një vepre penale.
5. Funkzioni i Kryetarit të Urdhrit është i papajtueshëm me çdo funksion tjetër administrativ, shtetëror apo politik.
6. Mandati i Kryetarit të Urdhrit mbaron para kohe në këto raste:
  - a) kur merret vendim nga Këshilli Kombëtar me votat e jo më pak se dy të tretave të anëtarëve;
  - b) kur jep dorëheqjen;

- c) kur dënohet me vendim gjykate të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
  - ç) kur humbet zotësinë e plotë për të vepruar;
  - d) kur bëhet i paaftë për arsye shëndetësore për të kryer detyrën, vërtetuar nga komisioni kompetent mjekësor;
7. Në rastet kur Kryetari i përfundon mandati përpara kohe për ndonjë nga arsyet e parashikuara nga pika 6 e këtij neni, kompetencat e tij i ushtron anëtari më i vjetër i Këshillit Kombëtar, i cili brenda 10 ditëve thërret Këshillin Kombëtar për të konstatuar ndërprerjen e mandatit të Kryetarit dhe thërret mbledhjen e Asamblesë për zgjedhjen e Kryetarit të ri, e cila duhet të mbahet jo më vonë se 30 ditë nga konstatimi i ndërprerjes së mandatit të Kryetarit.
8. Kryetari ka këto kompetenca dhe detyra:
- a) Të përfaqësojë institucionin në të gjitha marrëdhëniet juridike dhe administrative dhe të nënshkruajë, kur është rasti, në emër të tij;
  - b) Të delegojë kompetencat e tij nëpërmjet urdhërave të brendshëm, referuar legjislacionit, statutit dhe akteve të tjera normative në fuqi, në rast mungese ose me porosi;
  - c) Të drejtojë mbledhjet e Këshillit Kombëtar;
  - d) Të organizojë dhe drejtojë veprimtarinë e të gjithë institucionit për të siguruar funksionimin sa më të mirë të punës;
  - e) Të ndjekë bashkëpunimin me institucionet e tjera;
  - f) Të lidhë kontratat individuale me çdo punonjës të institucionit dhe t'i zgjidhë ato sipas legjislacionit të punës në fuqi;
  - g) Të drejtojë përpilimin e buxhetit dhe caktimin e prioriteteve për përdorimin e tij në mënyrë sa më të frytshme;
  - h) Të garantojë disiplinimin e administrimit e dokumentacionit në institucion në përputhje me aktet ligjore e nënligjore;
  - i) Të sigurojë etikën profesionale brenda institucionit së bashku me stafin;
  - j) Të përfaqësojë institucionin në marrëdhëniet me publikun, duke mbajtur qëndrim zyrtar në emër të tij.

### **Neni 23**

#### **Komisioni i Gjyimit Disiplinor Profesional**

1. Pranë Këshillit Kombëtar funksionon Komisioni i Gjyimit Disiplinor Profesional, i cili është organ i gjyimit profesional.
2. Komisioni verifikon dhe shqyrton ankesat e bëra nga çdo person apo institucion në organet e Urdhrit, të cilat lidhen me ushtrimin e profesionit dhe përbëjnë shkelje të Kodit të Etikës dhe Deontologjisë të Punonjësit Social.
3. Komisioni i Gjyimit Disiplinor Profesional përbëhet nga 7 anëtarë, të zgjedhur nga Këshilli Kombëtar. Anëtarët e zgjedhur të Komisionit të Gjyimit Disiplinor Profesional duhet të jenë anëtarë të Urdhrit të Punonjësve Socialë dhe të licensuar por nuk duhet të jenë anëtarë të Këshillit Kombëtar.
4. Mënyra e ngritjes dhe funksionimit të Komisionit të Gjyimit Disiplinor Profesional përcaktohet në rregulloren e gjyimit profesional të Urdhrit.

### **Neni 24**

#### **Masat disiplinore**

1. Komisioni i Gjyimit Disiplinor Profesional heton dhe gjykon në bazë të fakteve dhe provave të administruara dhe seancës dëgjimore. Kur vërtetohet se anëtari ka kryer shkelje të etikës, të Kodit të Etikës dhe Deontologjisë Profesionale ose ka bërë gabime teknike, ai jep këto masa:

- a) vërejtje me shkrim;
  - b) vërejtje me paralajmërim;
  - c) gjobë nga 5 000 deri në 50 000 lekë;
  - ç) pezullim nga e drejta e zgjedhjes në organet drejtuese të Urdhrit të Punonjësve Socialë deri në 3 vjet;
  - d) revokimin e licencës individuale profesionale dhe përjashtimin nga Urdhri për një periudhë deri në 3 vjet;
  - dh) propozim për shkarkim nga organet drejtuese.
2. Përveç masave të parashikuara në pikën 1, të këtij neni, si masë plotësuese komisioni ka të drejtë t'u caktojë të ndëshkuarve kryerjen e një rikualifikimi ose të studimeve plotësuese të përcaktuara me rregullore.
3. Masat disiplinore, të përmendura në pikën 1, të këtij neni, mund të shlyhen në qoftë se, brenda 1 viti nga data e dhënies së tyre, për shkronjat "a" dhe "b", dhe, brenda 3 vjetësh nga data e dhënies së tyre, për shkronjat "ç" dhe "d", ndaj anëtarit nuk është marrë ndonjë masë tjetër disiplinore.

### **Neni 25** **Ankimi**

1. Ankesat kundër vendimeve për marrjen e masave disiplinore nga Komisioni i Gjyimit Disiplinor Profesional paraqiten pranë këtij komisioni brenda 30 ditëve nga data e komunikimit me shkrim të vendimit.
2. Komisioni i Gjyimit Disiplinor Profesional, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së ankesës, detyrohet të japë vendimin për ankesën e paraqitur. Vendimi i Komisionit të Shqyrtimit Disiplinor Profesional është përfundimtar.
3. Vendimi i Komisionit të Shqyrtimit Disiplinor Profesional ankimohet në gjykatën kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative, sipas legjislacionit në fuqi.

### **Neni 26** **Koordinatori rajonal**

1. Këshilli Kombëtar zgjedh ndërmjet disa prej kandidaturave Koordinatorin Rajonal për çdo qark. Kandidatët për Koordinator Rajonal duhet të plotësojnë këto kritere:
- a) të jenë shtetas shqiptar me banim të përhershëm në Shqipëri;
  - b) të jenë anëtarë të Urdhrit;
  - c) të kenë përvojë jo më pak se 5 (pesë) vjet në ushtrimin e profesionit të punonjësve social;
  - ç) të mos kenë marrë masë disiplinore në 5 (pesë) vitet e fundit;
  - d) të mos jenë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
  - e) të kenë eksperiencë në koordinim aktivitetesh.
2. Koordinatorin Rajonal nuk është person juridik i veçantë, por pjesë e Urdhrit të Punonjësve Socialë dhe kryen veprimtaritë që i caktohen nga Këshilli Kombëtar i Urdhrit të Punonjësve Socialë bazuar në rregulloren e Këshillit Kombëtar.

**Neni 27**  
**Komisioni i Edukimit në Vazhdim**

1. Komisioni i Edukimit në Vazhdim është organi më i lartë vendimmarrës i Urdhrit të Punonjësve Socialë në lidhje me miratimin, garantimin e standarteve më të larta në lidhje me trajnimet profesionale të punonjësve sociale dhe mbikqyrjen e zbatimit të programeve të trajnimit profesional në fushën e punës sociale. Ai përbëhet nga 5 anëtarë, nga të cilët Kryetari i Urdhrit të Punonjësve Socialë i cili njëkohësisht është edhe kryetar i këtij Komisioni, ndërsa 4 anëtarët e tjerë përzgjidhen nga Këshilli Kombëtar i Urdhrit të Punonjësve Socialë, me konkurrim, nga radhët e anëtarëve të Urdhrit të Punonjësve Socialë dhe të botës akademike shkencore por nuk duhet të jenë anëtarë të Këshillit Kombëtar
2. Kriteret për të qenë anëtar i Komisionit të Edukimit në Vazhdim
  - a) Të ketë eksperiencë jo më pak se 10 vjet në ushtrimin e profesionit të punës sociale
  - b) Të mos ketë marrë masë disiplinore
  - c) Të mos jetë i dënuar.
3. Mënyra e ngritjes dhe funksionimit të Komisionit të Edukimit në Vazhdim përcaktohet në rregulloren e edukimit në vazhdim të Urdhrit.

**Neni 28**  
**Qëllimi dhe objekti i veprimtarisë të Komisionit të Edukimit në Vazhdim**

1. Komisioni i Edukimit në Vazhdim ka qëllim të garantojë ruajtjen e standardeve në lidhje me trajnimet profesionale të punonjësve sociale, nëpërmjet miratimit të programeve të akredituara dhe mbikqyrjes së zbatimit të programeve të trajnimit profesional në fushën e punës sociale, në kuadër të procesit të edukimit në vazhdim, për punonjësit social që ushtrjnë profesionin.
2. Urdhri i Punonjësve Socialë, nëpërmjet Komisionit të Edukimit në Vazhdim, bazuar në marrëveshje reciproke dhe në varësi të kapaciteteve, mund të miratojë, çertifikojë dhe mbikqyrë veprimtari të formimit profesional edhe për profesione të tjera, për të cilat kërkohet formim i posaçëm në fushën e punës sociale në territorin e Republikës së Shqipërisë.
3. Objekti i veprimtarisë së Komisionit të Edukimit në Vazhdim është miratimi, mbikqyrja dhe promovimi i programeve trajnuese dhe kërkimeve në fushën e trajnimit dhe të zhvillimit profesional të punonjësve socialë; bashkërendimi dhe mbikqyrja e trajnimeve, kërkimit shkencor dhe zhvillimit institucional në fushën e punës sociale.

**Neni 29**  
**Komisione të tjera**

1. Me vendim të Këshillit Kombëtar, në varësi të detyrave dhe problemeve, sipas rastit, krijohen komisione të përhershme ose të përkohëshme.
2. Veprimtaria e këtyre komisioneve bazohet në rregulloret përkatëse, të cilat miratohen nga Këshilli Kombëtar.

**Neni 30**  
**Kryetari dhe sekretari**

1. Kryetari I Urdhërit është njëkohësisht dhe Kryetari I Këshillit Kombëtar dhe drejton mbledhjet e tij, drejton diskutimet dhe siguron zbatimin e ligjit dhe marrjen e vendimeve të drejta. Këshilli ka një sekretar, i/e cili/a zgjidhet nga anëtarët e këtij organi me shumicë të thjeshtë votash.

2. Kryetari mund të shtyjë ose të mbyllë mbledhjen përpara kohe, në rastet kur situata e përligj këtë veprim. Në këto raste duhet të merret një vendim i arsyetuar, i cili do të pasqyrohet në procesverbalin e mbledhjes.

### **Neni 31**

#### **Zëvendësimi i përkohshëm i kryetarit dhe sekretarit**

1. Kryetari dhe sekretari zëvendësohen përkohësisht, përkatësisht nga anëtari më i vjetër dhe nga anëtari më i ri në detyrë i Këshillit Kombëtar, që të dy me të drejtë vote.

2. Në rastet kur anëtarët me të drejtë vote kanë shërbyer si anëtarë për një periudhë të njëjtë kohe, zëvendësimi i përkohshëm do të bëhet përkatësisht nga anëtari më i vjetër dhe nga ai më i riu në moshë i Këshillit Kombëtar.

### **Neni 32**

#### **Njoftimi për mbledhjet e Këshillit**

1. Kryetari njofton për datën, kohën dhe rendin e ditës së çdo mbledhje. Mbledhja e Këshillit njoftohet me shkrim, si rregull, 7 ditë përpara, duke bërë të ditur edhe rendin e ditës. Njoftimet për mbledhjet e Këshillit Kombëtar bëhen me postë zyrtare ose postë elektronike (e-mail).

### **Neni 33**

#### **Marrja e vendimeve**

1. Këshilli Kombëtar merr vendim vetëm për çështje të cilat janë përfshirë në rendin e ditës së mbledhjes, përveç rasteve kur të paktën 2/3 e anëtarëve janë dakord për shqyrtimin dhe marrjen e vendimeve edhe për çështje që nuk janë në rendin e ditës.

### **Neni 34**

#### **Vlefshmëria e mbledhjes**

1. Mbledhja e Këshillit Kombëtar është e vlefshme kur janë të pranishëm të paktën 1/2 e numrit të anëtarëve.

2. Kur në hapjen e mbledhjes kjo shumicë nuk arrihet, atëhere, Kryetari apo zëvendësi, që drejton mbledhjen, vendos thirrjen e mbledhjes një ditë tjetër, duke përsëritur njoftimin me shkrim.

### **Neni 35**

#### **Procesverbali i mbledhjes**

1. Në çdo mbledhje mbahet një procesverbal ku shkruhet data, vendi i mbledhjes, pjesëmarrësit, çështjet që u diskutuan, vendimet që u morën si dhe forma e rezultati i votimit. Sekretari i Këshillit mban procesverbalin e mbledhjes.

2. Në mbarim të mbledhjes, procesverbali nënshkruhet nga mbajtësi (sekretari) dhe Kryetari ose zëvendësi që ka drejtuar mbledhjen. Procesverbali i paraqitet në mbledhjen pasardhëse të gjithë anëtarëve që kanë marrë pjesë në mbledhje, me të drejtën për të nënshkruar me vërejtje për çdo kundërshtim që kanë në lidhje me përmbajtjen e procesverbalit. Të gjitha procesverbalet e mbledhjeve ruhen detyrimisht.

### **Neni 36**

#### **Forma e votimit në Mbledhjet e Këshillit Kombëtar**

1. Vendimet merren me votime të hapura, përveç rasteve kur me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm vendoset ndryshe. Vendimet që përmbajnë vleresime mbi sjelljen ose cilësitë e një individi merren me votim të fshehtë, përveç rasteve kur me shumicë votash vendoset ndryshe.

### **Neni 37**

#### **Vlefshmëria e votës për të marrë vendime në Këshillin Kombëtar**

1. Vendimet merren me shumicën e thjeshtë të votave të anëtarëve të pranishëm në mbledhje. Kur ka barazim të votave, kryhet një votim i dytë. Nëse edhe në votimin e dytë përsëritet e njëjta situatë, vota e Kryetarit është vendimtare.

## **KREU IV**

### **FINANCAT DHE BUXHETI**

#### **Neni 38**

##### **Buxheti**

1. Urdhri i Punonjësve Socialë ka buxhetin e tij, të cilin e miraton dhe monitoron Këshilli Kombëtar në përputhje me rregullat financiare në fuqi dhe me rregulloren e brendshme për veprimtarinë financiare të Urdhrit, të miratuar nga ky Këshill.

2. Burimet financiare të Urdhrit të Punonjësve Socialë janë të ardhurat nga:

a) kuotizacionet e anëtarëve, masa e të cilave përcaktohet me vendim të Këshillit Kombëtar dhe janë të detyrueshme për çdo anëtar;

b) tarifatat e vendosura për aktet dhe dokumentet e lëshuara nga Urdhri;

c) donacione të ndryshme dhe të ardhura të tjera të ligjshme.

3. Të ardhurat e siguruara, sipas përcaktimit të bërë në pikën 2, të këtij neni, Urdhri i përdor për të përmbushur synimet dhe objektivat e tij në përputhje me statutin dhe me këtë ligj.

#### **Neni 39**

##### **Kuotizacionet**

1. Kuotizacioni vjetor për anëtarët përcaktohet nga Këshilli Kombëtar në fundvit, në varësi të gjendjes, kërkesave dhe nevojave për të siguruar funksionimin normal të Urdhrit të Punonjësve Socialë. Propozimi për ndryshimin e kuotizacionit vjetor bëhet me shkrim nga cilido prej anëtarëve të Këshillit Kombëtar dhe duhet të përmbajë analizën e efekteve të pritshme financiare. Vendimi i Këshillit Kombëtar në lidhje me kuotizacionin mund të merret në çdo fundviti, dhe hyn në fuqi në vitin pasardhës financiar.

2. Shlyerja e kuotizacionit është e detyrueshme në fillim të çdo viti kalendarik dhe kushtëzon anëtarësinë në Urdhrit të Punonjësve Socialë.

#### **Neni 40**

#### **Përdorimi i burimeve financiare**

1. Burimet financiare të Urdhrit të Punonjësve Socialë përdoren për: a) Paga, honorare, shpërblime pune dhe kontributin për sigurimet shoqërore të punonjësve; b) Shpenzime operative; c) Shpenzime për organizim të veprimtarive shkencore, profesionale e kualifikuese d) Shpenzime për botime me karakter shkencor dhe informativ për nevojat e antarëve; e) Blerje mjetesh dhe pajisjesh pune për nevojat e veprimtarisë së Urdhrit të Punonjësve Socialë; f) Shpenzime për pritje e përcjellje delegacionesh e specialistësh nga organizma të ndryshme ndërkombëtare dhe vende të huaja; h) Ndihma në rast fatkeqësie për anëtarët e Urdhrit dhe familjet e tyre; i) Shpenzime të tjera të nevojshme për përmbushjen e misionit të Urdhrit

#### **KREU V**

#### **DISPOZITA PËRFUNDIMTARE**

#### **Neni 41**

#### **Emërtimi**

1. Emri i institucionit është “URDHRI I PUNONJËSVE SOCIALË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

#### **Neni 42**

#### **Stema dhe vula**

1. Urdhri ka stemën dhe vulën e tij.

2. Vula përftohet sipas legjislacionit në fuqi.

3. Logoja miratohet nga Këshilli Kombëtar dhe duhet të përmbajë një symbol që përfaqëson punën sociale, togfjalëshin “Urdhri i Punonjësve Socialë” dhe “Republika e Shqipërisë”, si dhe datën e asamblesë themeluese të Urdhrit.

#### **Neni 43**

#### **Selia**

1.Selia e Urdhrit të Punonjësve Socialë është në Tiranë.

**Neni 44**  
**Llogaria bankare**

1.Urdhri i Punonjësve Socialë mban llogari bankare në lekë dhe në valutë të huaj

**Neni 45**  
**Hyrja në fuqi**

1.Statuti i Urdhrit të Punonjësve Socialë hyn në fuqi menjëherë pas miratimit nga Këshilli Kombëtar